



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:030868
Datë: 01.08.2023
Numri i dokumentit: 04543996

C-IV-14-3410

Ankuesja

Sh K Mitrovicë.

Kundër

E paditura

N.SH “LUX”, në Likuidim, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**,

Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 01 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, MIT039-0571, i datës 16.04.2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- 3. HEDHET POSHTË si e pa pranueshme, ankesa e ankueses kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së MIT039-0569, i datës 16.04.2014.**
- 4. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 30 prill 2014, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. MIT039-0571, të datës 14 prill 2014, të Autoritetit të Likuidimit, me të cilin ka kërkuar kompensimin për 3 paga të papaguara, në shumë prej 180.00 Euro, si dhe kundër vendimit nr. MIT039-0569, të datës 14 prill 2014, të Autoritetit të Likuidimit, me të cilin ka kërkuar kompensimin për

ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 420.00 €uro nga N.SH “LUX” (në likuidim). Ankuesja i kundërshton vendimet e AL-së për arsye të shkeljes së prezumimeve procedurale konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së materiale. Ankuesja ka pohuar në ankesën e saj, se ka qenë punëtore aktive në ndërmarrjen e sipërpërmendur deri në momentin e privatizimit të Shtëpisë së mallrave, pronës së parë të privatizuar nga AKP-ja, konkretisht në muajin mars të vitit 2004, duke pretenduar se ka qenë në listën e pagave në tri vitet e fundit para privatizimit. Po ashtu ka pohuar se ajo ishte përfituese e 20%. Ankuesja i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesa e saj, si dhe ti njihet kompensimi i lartcekur. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar, Vendimin e kundërshtuar nr. MIT039-0571, të datës 14 prill 2014.

Me 13 mars 2023, gjykata lëshoi urdhër për ankuesen dhe kërkoi nga ajo që brenda afatit prej 7 ditësh, të parashtrij në gjykatë kopjen e vendimit të AKP-së nr. MIT039-0569 kundër të cilit është ushtruar ankesa, si dhe prova me të cilat e mbështet ankesën e saj. Po ashtu ankuesja është njoftuar se nëse nuk e përmbush urdhrin, atëherë ankesa e saj do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Nga fletë kthesa e Gjykatës është konstatuar se urdhri është pranuar me 16 mars 2023 por ankuesja nuk u përgjigj.

Me 24 maj 2023 e paditura AKP-ja parashtrij mbrojtje në ankesë, në të cilën i përmbahet qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, dhe të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankuesja nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankueses është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. E paditura i ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar, dhe të vërtetoj vendimin e AL-së. Përgjigjes në mbrojtje e paditura i ka bashkangjitur vendimin e AL-së nr. MIT039-0571, dhe vendimin për emërimin e anëtareve të autoritetit të likuidimit.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit sa i përket vendimit nr. MIT039-0571, të datës 14 prill 2014, refuzohet si e pabazuar, kurse ankesa e ankuesit sa i përket vendimit nr. MIT039-0569, të datës 14 prill 2014, hedhet poshtë si e papranueshme

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Kërkesa e ankuesit që ka të bëjë me tre pagat e pa paguara në shumë prej 180.00 €, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e N.Sh-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. Në çdo rast, një kërkesë e tillë duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohej fakti se N.SH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara.

Deri sa e paditura në vendimin e AL e ka kundërshtuar detyrimin e N.SH-së ndaj ankueses, duke theksuar se pagat e papaguar duhet të mbështeten me prova që vërtetojnë detyrimin e tilli të ndërmarrjes, kjo e fundit përveç pohimit, si dhe vendimit të kundërshtuar të AL-së, nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën do vërtetohej se N.sh-ja i ka mbetur borxh atij. Për më tepër ankuesja nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon pagat, ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për 3 paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Tutje kërkesa tjetër e ankueses e cila ka të bëjë me kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e që Autoriteti i Likuidimit me Vendimin nr. MIT039-0569, të datës 14 prill 2014, e ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga ankuesja, si të pavlefshme.

Ankuesja, ankesës nuk ia ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit të cilin e atakon.

Më 13 mars 2023, Gjykata lëshoj urdhër për ankuesen dhe kërkoi nga ajo që brenda afatit prej 7 ditësh, të parashtrij në gjykatë kopjen e vendimit të AKP-së kundër të cilit është ushtruar ankesa,

si dhe prova me të cilat e mbështet ankesën e tij. Po ashtu ankuesja është njoftuar se nëse nuk e përmbush urdhrin, atëherë ankesa e saj do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Nga fletë kthesa e Gjykatës është konstatuar se urdhri është pranuar me 16 mars 2023, por ankuesja nuk u përgjigj. Pra, meqenëse ankuesja dështoi në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrit të gjykatës për të dorëzuar kopjen e Vendimit të kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit, thjesht duke mos u përgjigjur në urdhrin e Gjykatës, kjo e fundit vendosi të hedh poshtë ankesën e saj si të papranueshme sa i përket vendimit nr. MIT039-0569, të datës 14 prill 2014.

Për këtë, në pajtim me nenet 36.1, 36.3 dhe 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Ankesa kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, hedhet poshtë si e papranueshme.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesja është e liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit është nën 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar